FLETËUDHËZUES I PAKETIMIT:
Informacion për pacientin

ERITROMICINE

Tableta të veshura me film – 250 mg

(Eritromicinë estolat)

Lexojeni me kujdes këtë fletëudhëzues përpara se të filloni përdorimin e barit.
- Ruajeni këtë fletëudhëzues. Mund të keni nevojë ta lexoni përsëri.
- Në qoftë se keni pyetje të mëtejshme, pyesni mjekun ose farmacistin tuaj.
- Ky bar është përshkruar për ju. Mos e jepni tek persona të tjerë. Mund t'i dëmtojë ata edhe pse mund të kenë të njëjtat simptoma si ju.
- Në qoftë se ndonjë prej efekteve anësore keqësohet ose në qoftë se vëreni ndonjë efekt tjetër anësor që nuk përmendet në këtë fletëudhëzues, ju lutemi të njoftoni mjekun ose farmacistin tuaj.

Në këtë fletëudhëzues:

1. Çfarë është Eritromicine dhe përse përdoret
2. Përpara se të merrni Eritromicine
3. Si ta merrni Eritromicine
4. Efekte anësore të mundshme
5. Si ta ruani Eritromicine
6. Informacion i mëtejshëm.

1 ÇFARË ËSHTË ERITROMICINE DHE PËRSE PËRDORET
Eritromicina është një antibiotik që i përket një grupi barnash të quajtura makrolidë. Këta antibiotikë e kryejnë veprimin duke vrarë ose duke ndaluar shtimin e baktereve që po shkaktojnë infeksion tek ju. Eritromicine, ashtu si antibiotikët e tjerë, nuk vepron ndaj infeksioneve virale siç është gripi.
Eritromicina përdoret për të trajtuar infeksione në pjesë të ndryshme të trupit të shkaktuara nga baktere, për shembull:
- alternativë e penicilinës në rastet me mbindjeshmëri ndaj kësaj të fundit;
- difteri dhe kollë e mirë;
- sëmundje e *Legionnaire;*
- bronkit akut (infeksion i bronkeve që shkakton kollë);
- pneumoni (infeksion i mushkërive i karakterizuar nga temperaturë, pafuqi, dhimbje koke);
- enterit nga kampilobakteri;
- uretrit jogonokoksik, prostatit kronik;
- sifiliz, akne vulgaris dhe rozacea.

Mjeku juaj mund ta ketë dhënë Eritromicine për një qëllim tjetër. Pyesni mjekun tuaj në qoftë se doni të dini pse ju është dhënë Eritromicine.

2. PËRPARA SE TË MERRNI ERITROMICINE
Mos merrni Eritromicine në qoftë se:
- jeni alergjik ndaj eritromicinës ose ndaj ndonjë antibiotiku tjetër makrolid p.sh.: azitromicin, klaritromicin ose roksitromicin;
- jeni alergjik ndaj ndonjërit prej përbërësve joaktivë të përmendur në fund të këtij fletëudhëzuesi;
- keni histori për sëmundje gastrointestinale;
- keni probleme të rënda me mëlçinë ose me tëmthin;
- keni probleme me dëgjimin;
- keni porfiri.
- keni nivele të ulëta të kaliumit ose magnezit në gjak (hipokalemi ose hipomagnezemi);
- ju ose dikush në familjen tuaj keni histori të çrregullimeve të ritmit të zemrës (aritmi ventrikulare ose torsadë të majës) ose nëse keni anomali në elektrokardiogramë (regjistrimi elektrik i zemrës) të quajtur "sindroma e intervalit të gjatë QT".

Eritromicine kundërindikohet gjithashtu në pacientët të cilët janë duke marrë astemizol, terfenadinë, cisaprid, pimozid, ergotaminë ose dihidroergotaminë, domperidon, simvastatinë, tolterodinë, mizolastinë, amisulprid.
Në qoftë se mendoni se keni ndonjë nga gjendjet e përmendura më sipër, mos i merrni tabletat. Shkoni dhe flisni fillimisht me mjekun tuaj dhe ndiqni këshillat e dhëna.

Tregoni kujdes të veçantë me Eritromicine
Njoftoni mjekun tuaj në qoftë se:
- planifikoni një shtatzëni gjatë kohës që jeni duke përdorur Eritromicine;
- jeni duke ushqyer foshnjen me gji ose po planifikoni të ushqeni foshnjen me gji;
- po trajtoni një fëmijë të vogël me antibiotikë dhe ai është nervoz ose ka të vjella kur ushqehet;
- po merrni edhe barna të tjerë, që njihen se shkaktojnë çrregullime serioze në ritmin e zemrës;
- keni ose keni patur ndonjë problem shëndetësor, në veçanti të mëposhtmet:
  - funksion të dëmtuar hepatik dhe biliar sepse rrit riskun për hepatotoksicitet (gjithashtu edhe në qoftë se përdorni barna hepatotoksike);
  - miastenia gravis;
  - aritmi ose predispozitë për zgjatje të intervalit QT;
  - diarre pas përdorimit të antibiotikëve.

Eritromicine mund të ndikojë në rezultatet e disa testeve laboratorike. Këshillohuni me mjekun tuaj përpara se t'i nënshtroheni çdo lloj testi nëse jeni duke marrë Eritromicine.

Marrja e barnave të tjera
Njoftoni mjekun ose farmacistin tuaj në qoftë se jeni duke marrë ose keni marrë së fundmi barna të tjera, edhe ato pa recetë. Informoni mjekun tuaj në qoftë se jeni duke marrë ndonjë prej këtyre barnave:
- teofilinë, një bar i përdorur për trajtimin e astmës;
- domperidon, një bar i përdorur për trajtimin e të vjellave dhe të përzierave (kundërindikohet);
- tolterodinë, një bar i përdorur për trajtimin e fshikëzës hiperaktive me simptoma si: urinimi i shpeshtë, i pavullnetshëm etj. (kundërindikohet);
- disa barna për trajtimin e migrenës si ergotamina ose dihidroergotamina (kundërindikohen);
- karbamazepinë, një bar i përdorur për trajtimin e epilepsisë;
- terfenadinë, astemizol apo mizolastinë, barna të përdorura për trajtimin e alergjive (kundërindikohen);
- barna kumarinikë si varfarinë apo acenokumarol, që përdoren për parandalimin e trombeve në gjak;
- digoksinë, një bar i përdorur për trajtimin e insufiçiencës kardiake;
- ciklosporinë, një bar i përdorur për parandalimin e mospranimit të transplantit ose për trajtimin e problemeve të caktuara të sistemit imun;
- cisaprid, një bar i përdorur për trajtimin e problemeve gastrointestinale (kundërindikohet);
- pimozid dhe amisulprid, barna antipsikotikë (kundërindikohen);
- ketapinë, bar antipsikotik;
- simvastatin, një bar që përdoret për uljen e kolesterolit (kundërindikohet); gjithashtu Eritromicine duhet të përdoret me kujdes me statina të tjera si lovastatin, atorvastatin, pravastatin etj.;
- vinblastinë, një bar që përdoret kundër kancerit;
- frenuesit e HIV - proteazës, barna që përdoren për trajtimin e infeksioneve virale, veçanërisht sakuinavir, i cili këshillohet të mos përdoret me Eritromicine;
- antimykotikë të grupit të azoleve (p.sh. flukonazol, ketokonazol etj.).

Eritromicina mund të ndërveprojë edhe me: opioide (si: alfentanil, buprenorfinë, oksikodon etj.), bromokriptinë, buspiron, klozapinë, kolkicinë, disopiramid, midazolam, alprazolam, inhibitorët e fosfodiesterazës tip 5 (sildenafil, avanafil, vardenafil, etj.), takrolimus, sirolimus, valproat, bllokues të kanaleve të kalciumit, zopiklon, cilostazol, kontraceptivë oralë, kortikosteroidë (p.sh. metilprednizolon), rifabutinë, cimetidinë.
Këto barna mund të ndikohen nga Eritromicine, ose mund të ndikojnë në mënyrën se si vepron. Mund të keni nevojë të përdorni sasi të ndryshme të këtij bari ose të merrni barna të tjera. Mjeku ose farmacisti juaj do t'ju këshillojë.
Kjo listë nuk është e plotë. Ka edhe barna të tjera që mund të ndërveprojnë me eritromicinën. Këshillohuni gjithmonë paraprakisht me mjekun.

Marrja e Eritromicine me ushqim dhe pije
Ushqimi nuk ndikon në përthithjen e eritromicinës estolat.

Shtatzënia
Njoftoni mjekun ose farmacistin tuaj në qoftë se jeni shtatzënë ose po planifikoni të ngeleni shtatzënë. Si shumica e barnave të këtij lloji, Eritromicine nuk është mirë të përdoret gjatë shtatzënisë. Mjeku ose farmacisti do të diskutojnë mbi rreziqet dhe përfitimet e marrjes së saj gjatë shtatzënisë.

Ushqimi me gji
Njoftoni mjekun ose farmacistin tuaj në qoftë se ushqeni foshnjen me qumësht gjiri. Eritromicina kalon në qumështin e gjirit. Mjeku ose farmacisti do të diskutojnë mbi rreziqet dhe përfitimet e marrjes së saj në qoftë se jeni duke ushqyer foshnjen me gji apo keni në plan ta bëni këtë.

Drejtimi i automjetit dhe përdorimi i makinerive
Tregohuni të kujdesshëm gjatë drejtimit të automjetit ose përdorimit të makinerive derisa të shihni se si Eritromicine ndikon tek ju. Eritromicine mund të shkaktojë marramendje ose trullosje në disa pacientë, veçanërisht pas marrjes së dozës së parë.

3. SI TA MERRNI ERITROMICINE
Gjithmonë merrini tabletat Eritromicine vetëm sipas këshillës së mjekut. Në qoftë se ndjeni që efektet e eritromicinës janë shumë të forta ose shumë të dobëta, flisni me mjekun ose farmacistin tuaj.
Tabletat mund të merren me ose pa ushqim. Këshillojmë që tabletat t'i merrni në të njëjtën orë çdo ditë.

Doza e rekomanduar për të rritur dhe fëmijë mbi 8 vjeç:
250 – 500 mg, çdo 6 orë ose 0.5 – 1 g, çdo 12 orë; në infeksionet e rënda mund të përdoren deri në 4 g në ditë.
Doza e rekomanduar për fëmijët deri në 2 vjeç: 125 mg, çdo 6 orë;
2 - 8 vjeç: 250 mg, çdo 6 orë; në infeksionet e rënda doza dyfishohet.
Në sifilizin e hershëm përdoren 500 mg, 4 herë në ditë, për 14 ditë, kurse në klamidien gjenitale të pandërlikuar dhe në uretritin jogonokoksik jepen 500 mg, 2 herë në ditë, për 14 ditë.
Megjithatë, mjeku juaj mund t'ju këshillojë të merrni një dozë tjetër në varësi të gjendjes tuaj dhe reagimit ndaj barit.
Mjeku juaj mund t'ju kërkojë të merrni Eritromicine për një kohë më të gjatë. Pyesni mjekun tuaj për këshillë në qoftë se nuk jeni të sigurt për sa kohë duhet ta merrni.
Tabletat Eritromicine duhet të gëlltiten të plota me një gotë ujë.

Në qoftë se keni marrë më shumë Eritromicine
Në qoftë se keni marrë më shumë Eritromicine se sasia që duhet të merrnit, ose në qoftë se fëmijët e kanë marrë gabimisht këtë bar, ju lutemi të kontaktoni mjekun tuaj, spitalin ose të telefononi urgjencën për të marrë një mendim për rrezikun dhe këshillë për veprimet që duhet të ndërmerren.

Në qoftë se keni harruar të merrni Eritromicine
Në qoftë se harroni një dozë, merrni dozën në vazhdim kur të jetë koha për marrjen e zakonshme të saj.
Mos merrni një dozë të dyfishtë për të plotësuar dozën e harruar.
Në qoftë se keni pyetje të mëtejshme mbi përdorimin e këtij produkti, pyesni mjekun ose farmacistin tuaj.

4. EFEKTE ANËSORE TË MUNDSHME
Të gjitha barnat mund të shkaktojnë efekte anësore. Ndonjëherë ato janë serioze, shumicën e herëve jo. Mos u alarmoni nga kjo listë e efekteve të mundshme anësore. Mund të mos ju shfaqet asnjë prej tyre.
Njoftoni mjekun tuaj në qoftë se ndonjë prej efekteve anësore të mëposhtme ju shqetëson:
- të përziera, të vjella, diarre (graviteti i këtyre efekteve është i lidhur me dozën), pankreatit, anoreksi, kolit pseudomembranoz, stenozë hipertrofike e pilorit tek fëmijët e vegjël me simptoma të tilla si: të vjella dhe nervozizëm;
- marramendje ose trullosje, konvulsione, haluçinacione;
- reaksione alergjie – ekzantema, urtikarie;
- zhurmë në vesh (tinitus), humbje e prapësueshme e dëgjimit pas përdorimit të dozave të larta dhe në të sëmurët e moshuar ose me insufiçiencë renale dhe hepatike;
- ikter kolestatik në qoftë se përdoret më shumë se 14 ditë dhe çrregullime të tjera si: hepatomegali (zmadhim i mëlçisë), insufiçiencë hepatike etj.;
- rritje e enzimave të mëlçisë;
- dëmtim i shikimit / turbullim i shikimit;
- inflamacion i veshkave (nefrit intersticial);
- rritje e numrit të një lloji të qelizave të bardha të gjakut (eozinofili);
- temperaturë, gjendje e përgjithshme jo e mirë;
- efekte në zemër (përfshirë dhimbje gjoksi, aritmi dhe palpitacione), rënie e presionit të gjakut;
- sindrom Stivens – Xhonson;
- nekrolizë epidermale toksike, eritema multiforme etj.

Njoftoni menjëherë mjekun nëse ju shfaqet një reaksion serioz në lëkurë: rash, me skuqje, në trajtë luspash, me gunga nën lëkurë dhe flluska (pustulozë ekzantematoze).
Frekuenca e këtij efekti nuk njihet (nuk mund të përcaktohet nga të dhënat që disponohen).
Në qoftë se vëreni efekte anësore që nuk janë të përmendura në këtë fletëudhëzues, ju lutemi të njoftoni mjekun ose farmacistin tuaj.

5. SI TA RUANI ERITROMICINE
Mbajeni larg fëmijëve.
Mos e përdorni Eritromicine pas datës së skadimit e cila është e shënuar në paketim.
Mos e ruani mbi 25°C.

6. INFORMACION I MËTEJSHËM
Çfarë përmban Eritromicine
Lënda aktive është eritromicinë estolat.
Çdo tabletë e veshur me film përmban 360 mg eritromicinë estolat ekuivalent me 250 mg eritromicinë bazë.
Lëndët ndihmëse janë:
bërthama e tabletës: amidon, xhelatinë, stearat magnezi, talk, glikolat natriumi i amidonit;
veshja me film: alkool polivinilik, dioksid titani, makrogol, talk.

Përmbajtja e paketimit:
Kuti me 30, 50 tableta të veshura me film.

Mbajtësi i Autorizimit për Tregtim dhe Prodhuesi:

PROFARMA sh.a.,
Rruga "Skënder Vila",
Tiranë, Shqipëri.
Tel.: +355 4 23 89 602

Ky fletudhëzues u rishikua për herë të fundit në Nëntor 2023.

SPECIFICATION

CROPING AREA 15 X 25 cm

PAY ATENTION, all the layers are visible. If you have to print this document please check or uncheck the specific layers.